

Në bazë të nenit 25 paragrafi 4 të Ligjit të Veprimtarisë Inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16, 190/16 dhe 64/18), Bordi Drejtues i Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi vijuesin

**RREGULLORE**  
**për instrumentin mbështetës -**  
**Grantet e bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve**

**I.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Lënda**

**Neni 1**

(1) Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret më të afërta për ndarjen e mjeteve përmes instrumentit Grantet e bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve, si dhe mënyra e ndarjes së mjeteve, përmbajtja e konkursit publik për ndarjen e mjeteve, mënyra e vlerësimit të propozim-projekteve të paraqitura , mënyra e promovimit, si dhe procedurat e tjera që lidhen me ndarjen e mjeteve nga ky instrument.

**Definicionet**

**Neni 2**

(1) Në këtë rregullore, përveç definicioneve të Ligjit të veprimtarisë inovative, definicionet dhe sqarimet përdoren me kuptimin vijues:

1. "**Aplikues**" do të thotë një shoqëri tregtare që i ka paraqitur një propozim-projekt Fondit në një konkurs publik të hapur për ndarjen e mjeteve në përputhje me këtë Instrument.
2. "**Kontrata për ndarjen e mjeteve**" nënkupton një kontratë midis Fondit dhe një përfituesi të zgjedhur, për dhënien e fondeve në përputhje me këtë Instrument, të lidhur në përputhje me rregullat dhe procedurat e specifikuar në këtë Rregullore.
3. "**Komiteti i Miratimit të Investimeve**" do të thotë një Komitet i krijuar në përputhje me Ligjin e Veprimtarisë Inovative.

4. "**Shfrytëzues**" do të thotë Aplikuesi që i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të kësaj Rregullore dhe që ka nënshkruar një kontratë për ndarjen e mjeteve me Fondin.
5. "**Plani për menaxhimin me mjedisin jetësor**" do të thotë planë për menaxhimin me mjedisin jetësor për projektet e inovacionit të përpunuara në përputhje me rregulloret në fuqi për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zvogëlimin e ndotjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën janë dhënë informacione të detajuara përi masat që janë të përshtatshme, respektivisht të domosdoshme për të maksimizuar përfitimet nga Projekti, eliminimin, kompensimin ose zbutjen e të gjitha efekteve të dëmshme në mjedisin jetësor, domethënë zvogëlimin e efekteve të tilla në një nivel të pranueshëm, së bashku me vlerësimet e buxhetit dhe të shpenzimeve, burimet e financimit, aranzhimet e përshtatshme institucionale dhe aranzhimet e monitorimit dhe njoftimet që mundësojnë zbatimin dhe dorëzimin e përshtatshëm në informacione të rregullta kthyesë mbi pajtueshmërinë me një plan të tillë të menaxhimit të mjedisit jetësor.
6. "**Ndryshimi i pronësisë së kapitalit**" nënkupton, marrjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, gradualisht ose menjëherë në një pjesë ose aksion të kryegjës të shfrytëzuesit, nga çdo person fizik ose person juridik përmes shitjes, dhuratës, trashëgimit (përfshirë edhe në rastin e vdekjes së parterit të shumicës, d.m.th aksionari i shfrytëzuesit), likuidimi, ndryshimi i statusit ose një lloj tjetër kontrate ose transferimi.
7. "**Rregullore**" nënkupton këtë rregullore për Instrumentin e mbështetjes - Grantet e bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve të Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik të miratuara nga bordi Drejtues i Fondit.
8. "**Propozim-projekti**" nënkupton një projekt të paraqitur në një konkurs publik të hapur për ndarjen e mjeteve sipas këtij Instrumenti të Fondit në mënyrë që të financohet përmes një granti të bashkëfinancuar në përputhje me kriteret dhe procedurën e parashikuar në këtë rregullore.
9. "**Rezultatet e Projektit**" nënkupton çdo rezultat të prekshëm ose jo -material të Projektit, të cilit i përket marrëveshja e dhënies, të tilla si të dhëna, njohuri ose informacion, në çdo formë dhe të çdo natyre, pavarësisht nëse ato mund të mbrohen ose jo, të cilat krijohen përmes aktivitete të tilla të projektit, si dhe çdo të drejtë mbi to, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.
10. "**Ekspertët**" janë bashkëpunëtorë ekspertë të jashtëm të angazhuar nga Fondi në përputhje me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së ekspertëve në punën e Fondit gjatë vlerësimit dhe dhënies së mendimit ekspert mbi mënyrat e zbatimit të fazës së parapërzgjedhjes të propozim-projekteve sipas këtij Instrumenti.
11. "**Faza e parapërzgjedhjes**" është një fazë vlerësimi e zbatuar nga Ekspertët, të emëruar nga Fondi, të cilët rishikojnë materialin, paraqesin vlerësimin dhe mendimin e ekspertëve

mbi propozim-projektet, të cilat korrespondojnë me kriteret e vlerësimit, pra me mënyrat e Instrumentit.

12. "**Faza e zgjedhjes**" është një fazë vlerësimi e zbatuar nga Komiteti i Miratimit të Investimeve, i cili kryen vlerësimin e propozim-projekteve që kanë kaluar fazën e parapërzgjedhjes dhe merr një vendim përfundimtar për financimin përmes Instrumenteve të Fondit.
13. "**Fondi**" është Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
14. "**Ndryshimi i statusit**" është bashkëngjitja, bashkimi dhe ndarja e një shoqërie tregtare në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin e shoqërive tregtare,

### **Qëllimi dhe përshkrimi i instrumentit**

#### **Neni 3**

(1) Qëllimi i Instrumentit Mbështetës - grantet e bashkë-financuara për komercializimin e inovacioneve (në tekstin e mëtejshëm: instrumenti) është të inkurajojë rritjen e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit në sektorin privat, të inkurajojë bashkëpunimin midis sektorit privat dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit, si dhe forma të tjera të bashkëpunimit për komercializimin e inovacioneve.

#### **Neni 4**

(1) Instrumenti ka për synim ndërmarrjet që duan të zhvillojnë një produkt, shërbim ose proces inovativ, vetëm ose në bashkëpunim me një ndërmarrje dhe/ose institucion tjetër që kryen arsim të lartë, pra veprimtari kërkimor-shkencor. Instrumenti ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet e regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në mënyrë që të zhvillojnë dhe zbatojnë zgjidhje inovative, duke përfshirë mbështetjen për ndërmarrjet me potencial të lartë rritjeje.

(2) Mbështetja përmes këtij instrumenti do t'i ndahet projekteve me një qëllim të qartë komercial që janë në fazën e prototipit (ose faza e përshtatshme në varësi të llojit të produktit, shërbimit, procesit inovativ) deri në fazën para-komerciale (para-tregut).

### **Kriteret e përgjithshme për bashkëfinansim nga Fondi përmes këtij instrumenti**

#### **Neni 5**

(1) Përmes këtij instrumenti Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik (në tekstin e mëtejshëm: Fondi) siguron mbështetje financiare në shumën maksimale prej 20,000,000.00 (njëzet milionë) denarë, dhe atë:

- për ndërmarrjet, numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është deri në 50 (pesëdhjetë) punonjës dhe të ardhurat vjetore të të cilëve në dy vitet e fundit janë më pak se 2,000,000.00 (dy milionë) euro, duke financuar deri në 70% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, domethënë
- për ndërmarrjet numri mesatar i të punësuarve i të cilëve është nga 50 (pesëdhjetë) deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) dhe të ardhurat vjetore të të cilëve në dy vitet e fundit janë më shumë se 2,000,000.00 (dy milionë) euro, dhe më pak se 10,000,000.00 (dhjetë milionë) euro, financim deri në 60% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

Shuma e të ardhurave vjetore të realizuara dhe numri mesatar i punonjësve përcaktohet në përputhje me raportet financiare për dy vitet e fundit kalendarike.

Kufijtë maksimalë të të ardhurave të realizuara sipas të cilave përcaktohet përqindja e bashkëfinancimit shprehen në euro dhe llogariten sipas kursit mesatar të këmbimit të BPRM për Euro në ditën e shpalljes së thirrjes publike.

Në rast kur Aplikuesi nuk i plotëson vlerat e të dy indikatorëve (numri i punonjësve dhe shuma e të ardhurave vjetore) në mënyrë kumulative, si bazë për përcaktimin e përqindjes së bashkëfinancimit nga Fondi do të konsiderohet indikator i sipas të cilit Aplikuesi duhet të sigurojë një përqindje më të lartë të bashkëfinancimit.

Për shembull: nëse aplikuesi ka 20 punonjës dhe të ardhura vjetore në dy vitet e fundit prej 3,000,000.00 (tre milionë) euro, aplikuesi do të mund të aplikojë për financim deri në një maksimum prej 60% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

Nëse një ose më shumë persona fizikë dhe/ose persona juridik brenda konkursit publik paraqiten në strukturën e pronësisë së më shumë se një aplikuesi, dhe në rast se aplikuesit e tillë zgjidhen për financim, shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare për aplikuesit e tillë së bashku nuk mund të kalojë kufizimet e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, të cilat vlejné për një aplikues.

(2) Të përshtatshme për financim janë propozim-projektet nga të gjithë sektorët, përveç për:

- veprimtaritë e prodhimit, tregtisë ose shërbimeve që nuk janë në përputhje me ligjin;

- prodhimi dhe tregtimi i duhanit, pijeve alkoolike të distiluara dhe produkteve të përafërta (pije që përmbajnë alkool, por jo të marra ekskluzivisht me distilim, por për prodhimin e tyre mund të përdoret gjithashtu alkool i distiluar i natyrshëm (i marrë me origjinë të ndryshme por natyrore) duke dhënë produkte të ndryshme bimore ose produkte të tjera , ku përmes maceracionit, bashkimit (përzierjes), aromatizimit, ngjyrosjes, plakjes, dhe të ngjashme merren me pije të ndryshme alkoolike në të cilat përmbajtja e alkoolit etilik është zakonisht më e lartë se 15%, dhe ato mund të përfshijnë lloje të ndryshme të likerëve dhe koktejeve, dhe të ngjashme);
- prodhimin dhe tregtimin me armë dhe municioneve të cilit do lloj;
- kazinotë dhe personat e tjerë juridikë për organizimin e lojërave të fatit dhe lojërave të tjera argëtuese;
- Kërkimet hulumtuese, zhvillimore ose teknike që kanë të bëjnë me të dhënat elektronike, programet ose zgjidhjet, të cilat kanë të bëjnë me:
  - a) mbështetjen e cilit do aktivitet që përfshihet në sektorët e mësipërm të nënparagrafeve 2.3 dhe 4 të këtij neni;
  - b) lojërat e fatit në internet dhe kazinotë online dhe/ose
  - c) pornografia;
- kërkimi shkencor-natyror, zhvillimi ose aplikimet teknike në lidhje me klonimin njerëzor për qëllime kërkimore ose terapeutike; dhe/ose për organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ).

(3) Propozim-projektet mund të paraqiten nga një aplikues individual ose nga një konsorcium i udhëhequr nga aplikuesi.

(4) Bashkëpunimi midis sektorit privat dhe arsimit të lartë, respektivisht institucioneve kërkimore shkencore ose formave të tjera të bashkëpunimit për komercializimin e inovacioneve do të konsiderohet si përparësi në propozim-projekt.

## **Kriteret e përgjithshme për bashkëfinancim nga aplikuesi në lidhje me këtë Instrument**

### **1. Neni 6**

(1) Nëse Fondi vendos të mbështesë propozim-projektin e Aplikuesit përmes këtij Instrumenti, Aplikuesi është i detyruar të sigurojë bashkëfinancimin e tij në shumën të paktën 30% ose 40%

të buxhetit të përgjithshëm të projektit, në varësi të kushteve të parashikuara në nenin 5, paragrafi 1 të kësaj Rregullore.

(2) Mjetet e marra nga Fondi në çfarëdo baze tjetër, si dhe mjetet e marra në bazë të ndonjë ndihme tjetër shtetërore, nuk do të konsiderohen si mjete të pranueshme për bashkëfinancim nga Aplikuesi.

## **Kohëzgjatja e projektit**

### **Neni 7**

(1) Kohëzgjatja e projektit për të cilin janë ndarë mjetet financiare përmes këtij instrumenti mund të jetë deri në 24 (njëzet e katër) muaj.

(2) Në bazë të arsyeve të justifikuara, shfrytëzuesi mund të kërkojë vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit duke paraqitur një kërkesë të arsyetuar me shkrim që tregon arsyet e vazhdimin. Kërkesa paraqitet para skadimit të kohëzgjatjes së projektit.

(3) Bazuar në kërkesën e paraqitur në paragrafin (2), Fondi mund të miratojë vazhdimin e zbatimit të projektit deri në 3 (tre) muaj.

(4) Vazhdimi i zbatimit të projektit më të gjatë se periudha në paragrafin (3) të këtij neni mund të miratohet vetëm me një vendim të sjellur nga Komiteti i Miratimit të Investimeve.

(5) Në rrethana të justifikuara, kohëzgjatja e zbatimit të projektit mund të vazhdohet më së shumti prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh shtesë pas miratimit të marrë më parë në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

(6) Në rast se Fondi, përkatësisht Komiteti sjell vendim për vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit, vazhdimi i kohëzgjatjes do të fillojë nga dita e marrjes së vendimit për vazhdim. Në periudhën nga skadimi i kohëzgjatjes së projektit deri në ditën e vendimit për vazhdimin nga Fondi ose Komiteti, Shfrytëzuesit nuk do t'i njihen asnjë shpenzim dhe aktivitet dhe i njëjti është i detyruar ose të përmbahet nga bërja e ndonjë shpenzimi dhe marrjeve të aktiviteteve ose vet të përballojë shpenzimet e bëra.

(7) Në rast të vazhdimin të kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, shuma e grantit të ndarë nuk mund të rritet.

## **Kriteret e përshtatshmërisë për Aplikuesin**

### **Neni 8**

(1) Kriteret e përshtatshmërisë që aplikuesi duhet të plotësojë janë:

- të jetë një shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin e shoqërive tregtare dhe e regjistruar në regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ardhurat vjetore të aplikuesit nuk duhet të kalojnë 10,000,000 (dhjetë milionë) euro, sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme fiskale;
- numri mesatar i të punësuarve sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme nuk duhet të kalojë 250 punonjës;
- të mos jetë i lidhur (sipas Ligjit të shoqërive tregtare) me një ndërmarrje tjetër, të ardhurat vjetore të së cilës tejkalojnë 10,000,000 (dhjetë milionë) euro dhe numri mesatar i të punësuarve nuk i kalon 250 në dy vitet e mëparshme fiskale, përveç në rast të lidhjes me arsimin e lartë, respektivisht institucionit kërkimor-shkencor;
- aplikuesit me mbi 3 (tre) vjet ekzistencë deri në momentin e aplikimit nuk kanë bërë humbje në përputhje me raportet financiare për dy vitet e fundit kalendarike, në përputhje me nenin 14 paragrafi 1 nënparagrafi 5 i Rregullores dhe dispozitave të konkursit Publik;
- aplikuesi, deri në momentin e aplikimit për thirrjen publike, nuk ka asnjë projekt aktual (aktiv) që mbështetet financiarisht nga Fondi në bazë të ndonjë prej instrumenteve mbështetëse;
- asnjë procedurë falimentimi ose likuidimi nuk është filluar kundër tij;
- të ketë shlyer detyrimet e duhura në bazë të detyrave dhe kontributeve publike;
- asnjë procedurë nuk është filluar kundër tij për ekzekutimin me dhunë të kërkesave monetare të prapambetura;
- të plotësojë kushtet e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe kushtet e nenit 6 të Dekretit mbi kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës horizontale.

### **Neni 9**

(1) Një aplikues individual mund të lidhë një marrëveshje bashkëpunimi (nën-kontratë për shërbime) për kërkimin dhe zhvillimin me institucionet që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë dhe/ose kërkimit shkencor në vend dhe jashtë vendit ose me një ndërmarrje tjetër.

(2) Në rast të një propozim-projekti të paraqitur nga një aplikues individual që përfshin një marrëveshje bashkëpunimi për kërkim dhe zhvillim, të drejtat dhe detyrimet e aplikuesit dhe institucionit të arsimit të lartë dhe/ose kërkimit shkencor do të rregullohen në marrëveshjen e bashkëpunimit.

(3) Ndarja e të drejtave dhe detyrimeve si dhe rishpërndarja e buxhetit të projektit duhet të argumentohet mirë në propozim-projektin.

### **Neni 10**

(1) Në rast të propozim-projekteve të paraqitura nga një konsorcium, propozim-projekti në emër të konsorciumit do të paraqitet nga një aplikues kryesor.

(2) Aplikuesi kryesor duhet të plotësojë kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në nenin 8 të kësaj Rregullore.

(3) Anëtarët e konsorciumit mund të jenë: ndërmarrjet, arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore shkencore nga vendi dhe jashtë tij.

(4) Në rast të një propozim-projekti të paraqitur nga një konsorcium ndërmarrjesh me numër të ndryshëm të të punësuarve dhe të ardhurave, përqindja e bashkëfinancimit do të përcaktohet sipas madhësisë së ndërmarrjes që realizon të ardhura më të larta në nivel vjetor dhe ka një numër më të madhë të punësuar, pavarësisht se cila ndërmarrje shfaqet si aplikuesi kryesor.

Për shembull: kur një propozim projekt paraqitet nga një konsorcium i përbërë nga një aplikues kryesor i cili ka 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës dhe të ardhura deri në 2,000,000.00 (dy milionë) euro dhe një anëtar konsorciumi i cili ka 200 (dyqind) punonjës dhe të ardhura prej 5,000 .000,00 (pesë milionë) euro, përqindja e bashkëfinancimit do të jetë identike me atë që është e vlefshme për ndërmarrjet, numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është nga 50 (pesëdhjetë) deri në 250 (dyqind e pesëdhjetë) dhe të ardhurat e tyre vjetore në dy vitet e fundit është më e madhe se 2,000,000.00 (dy milionë) euro, dhe më pak se 10,000,000.00 (dhjetë milionë) euro, respektivisht (60% Fondi / 40% aplikuesi).

(5) Në rast të një propozim-projekti të paraqitur nga një konsorcium, e drejta për të komercializuar rezultatet e projektit duhet t'i takojë ekskluzivisht Aplikuesit Kryesor.

(6) Secili anëtar i konsorciumit duhet të plotësojë kriteret vijuese:

- të ardhurat vjetore nuk duhet të kalojnë 10,000,000.00 (dhjetë milionë) euro, sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme fiskale, përveç rasteve kur anëtari i konsorciumit është i arsimit të lartë, respektivisht institucionit kërkimor shkencor;
- numri mesatar i të punësuarve sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme nuk duhet të kalojë 250 punonjës, përveç rasteve kur anëtari i konsorciumit është i arsimit të lartë, respektivisht institucionit kërkimor shkencor;
- asnjë procedurë falimentimi ose likuidimi nuk është filluar kundër tij;



- të ketë shlyer detyrimet e duhura në bazë të detyrave dhe kontributeve publike;
- asnjë procedurë nuk është filluar kundër tij për ekzekutimin me dhunë të kërkesave monetare të prapambetura;
- të plotësojë kushtet e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe kushtet e nenit 6 të Dekretit mbi kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës horizontale;

(7) Të drejtat dhe detyrimet midis anëtarëve të konsorciumit duhet të rregullohen me një marrëveshje konsorciumi.

(8) Ndarja e të drejtave dhe detyrimeve si dhe rishpërndarja e buxhetit të projektit duhet të argumentohet mirë në propozim-projektin.

(9) Nëse një propozim-projekt i paraqitur nga një konsorcium miratohet për financim, Fondi nënshkruan një Kontrate për ndarjen e mjeteve me Aplikuesin Kryesor.

(10) Aplikuesi kryesor bëhet shfrytëzues i një granti të bashkëfinancuar nga Fondi dhe është përgjegjës për menaxhimin financiar të mjeteve të ndara në përputhje me Kontratën e ndarjes së mjeteve.

### **Neni 11**

(1) Mjetet e marra nga Fondi duhet të jenë të destinuara për aktivitetet zhvillimore dhe për zbatimin e inovacionit të propozuar.

(2) Aktivitetet e pranueshme të financimit janë këto:

- aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit;
- aktivitetet e testimit;
- aktivitetet që lidhen me mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- dizajn;
- zhvillimin e linjave pilot;
- aktivitetet që lidhen me sigurimin e cilësisë;
- aktivitetet e marketingut dhe shitjes (që synojnë sjelljen e inovacionit në gatishmërinë e investimeve dhe pjekurinë për të vendosur në treg).

### **Shpenzimet e përshtatshme për financim**

### **Neni 12**

(1) Shpenzimet e pranuar për financim sipas këtij instrumenti janë:

- pagat bruto për punonjësit e aplikuesve dhe anëtarët e konsorciumit që do të angazhohen në projekt. Shumat e pagave bruto të punonjësve të angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikën e vendosura të shfrytëzuesit para fillimit të projektit, të zvogëluara me shumën e subvencionit të mundshëm shtetëror të marrë në bazë të pagës; furnizimi dhe/ose marrja me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për kërkim dhe zhvillim;
- shërbimet e nënkontraktuara të kërkimit dhe zhvillimit të (p.sh. testimi, shërbimet laboratorike, dhe të ngjashme);
- angazhimin e ekspertëve/këshilltarëve të kërkimit dhe zhvillimit;
- angazhimin e konsulentëve për nevoja të tjera të lidhura drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme të projektit (ekspertizë në lidhje me menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar, mobilizimin e mjeteve, zhvillimin e biznesit, marketingun, çështjet juridike, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, etj);
- përgatitjen dhe paraqitjen e një kërkese për patentë, mbrojtjen e markës tregtare dhe/ose dizajnin industrial;
- shpenzimet e marketingut;
- mbështetje zyre dhe biznesi (marrja me qira e lokaleve për biznes, shpenzimet e përgjithshme, provizionet bankare, shërbimet e kontabilitetit, hosting dhe llojet e tjera të ndihmës administrative) në një shumë maksimale prej 10% (dhjetë përqind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

(2) Vetëm shpenzimet e kryera për aktivitetet e kryera gjatë kohëzgjatjes së projektit, të cilat janë në përputhje me buxhetin e projektit të miratuar dhe rregullat dhe procedurat e Fondit janë të përshtatshme për financim.

(3) Shpenzimet që nuk janë të përshtatshme për financim sipas këtij instrumenti janë:

- shtesat e pagave të përcaktuara në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës;
- shpenzimet për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga ndërmarrjet publike vendore;
- shlyerja e interesit ose borxhit ndaj një pale tjetër;
- shpenzimet dhe provizionet për humbjet ose borxhet e kaluara dhe të mundshme në të ardhmen;

- humbjet dhe ndëshkimet e kursit të këmbimit;
- shpenzimet e argëtimit dhe hotelierisë;
- shpenzimet e rekrutimit të stafit (shpenzimet për publikimin e shpalljes, provizionet nga agjencitë e punësimit, shpenzimet që lidhen me përzgjedhjen e kandidatëve, etj.) dhe shpenzimet e zhvendosjes;
- blerja e tokës ose ndërtesave, përfshirë edhe rinovimin;
- pagesa me para në dorë nga llogaria e caktuar e projektit;
- tarifat vjetore për mbajtje të patentës (me përjashtim të rasteve të justifikuara mirë të vlerësuara si një shpenzim i lejuar kur vlerësohen propozim-projektet);
- shpenzimet për shërbimet e konsulentëve të siguruara nga pronari/ët tek shfrytëzuesit/anëtarit të konsorciumit;
- shpenzimet për shërbimet e konsulentëve të siguruara nga personat e punësuar nga Shfrytëzuesi/anëtari i konsorciumit;
- marrja me qira e lokaleve të biznesit nga një qiradhënës i cili merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është një person i lidhur me shfrytëzuesin/anëtarin e konsorciumit;
- furnizimi i automjeteve të transportit të mallrave nga ndërmarrjet që kryejnë transportin rrugor të mallrave me qira ose kompensim;
- furnizimi i automjeteve të pasagjerëve (me përjashtim të rasteve të justifikuara mirë të vlerësuara si shpenzime të lejueshme kur vlerësohen propozim-projektet);
- shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të financuara më parë nga burime të tjera;
- shpenzimet për furnizimin e pajisjeve të shfrytëzuara dhe
- tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) për të gjitha furnizimet në paragrafin 1 të këtij neni.

(4) Lista e shpenzimeve nga paragrafi 3 i këtij neni nuk është shteruese.

## **II PROCESI I APLIKIMIT**

### **Konkursi publik**

#### **Neni 13**

(1) Mjetet financiare sipas këtij Instrumenti ndahen në baza konkurruese pas shpalljes së një konkursi publik.

(2) Fondi shpall konkurs publik me procedurë të rregullt dhe konkurs publik me procedurë të shkurtër.

(3) Konkursi publik publikohet në të paktën dy media publike dhe në faqen e internetit të Fondit.

(4) Afati për paraqitjen e propozim-projekteve do të përcaktohet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga shpallja e konkursit publik nga Fondi dhe mund të vazhdohet për shkak të rrethanave të justifikuara.

(5) Buxheti i përgjithshëm i çdo konkursi publik përcaktohet nga Fondi në përputhje me Programin Vjetor të Punës të Fondit dhe/ose Programin Afatmesëm të Punës të Fondit.

### **Përmbajtja e konkursit publik**

#### **Neni 14**

(1) Konkursi publik duhet t'i përmbajë informacionet vijuese:

- të dhënat për organin që shpall thirrjen;
- data e shpalljes së konkursit publik;
- mënyra e paraqitjes së propozim-projektit dhe dokumentacionit shoqërues;
- afati i fundit për paraqitjen e propozim-projektit;
- përshkrim i shkurtër i Instrumentit, duke përfshirë kriteret e përshtatshmërisë të Aplikuesit dhe vitet që konsiderohen kompetent në përcaktimin e indikatorëve: të ardhurat vjetore, numri mesatar i punonjësve dhe humbja e ndërmarrjeve;
- aktivitetet dhe shpenzimet që janë të përshtatshme dhe shpenzimet që nuk janë të përshtatshme për financim;
- buxheti i përgjithshëm për konkursin;
- informacion kontaktues;
- të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e thirrjes publike.

(2) Të gjitha të dhënat e mësipërme duhet të përmbahen në konkursin publik të publikuar në faqen e internetit të Fondit. Një version i shkurtuar do të përgatitet për konkursin publik të publikuar në media.

### **Aplikimi me procedurë të rregullt**

#### **Neni 15**

(1) Kur aplikoni për marrje të mjeteve financiare përmes këtij Instrumenti të Fondit, duhet të dorëzohen dokumentet vijuese:

1. Dokumentacioni i projektit (i cili përmban formularët për propozim-projektin, të disponueshëm përmes faqes së internetit të Fondit) i cili përbëhet nga :

- një formular aplikimi për projektin e plotësuar mirë;
- një formular i buxhetit të projektit të plotësuar mirë;
- deklarata e Aplikuesit për pranimin e kushteve të Fondit;
- pyetësori i plotësuar mirë për mjedisin jetësor dhe
- deklarata e noterizuar mbi pronësinë - strukturën themeluese të aplikuesit.

2. Dokumentacioni i siguruar nga Aplikuesi:

- biografi të shkurtra të personave që përbëjnë ekipin e projektit të angazhuar në projekt (maksimumi për 5 (pesë) persona);

(2) Aplikimi për projekt, buxheti i projektit dhe CV-të duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase dhe angleze.

(3) Dokumentacioni tjetër i lidhur me aplikuesit duhet të dorëzohet vetëm në gjuhën maqedonase.

(4) Dokumentacioni i projektit duhet të dorëzohet në formularët e përgatitur nga Fondi.

(5) Në rast se projekti bazohet në të drejtat ekzistuese të pronësisë intelektuale, Aplikuesi është i detyruar së bashku me dokumentacionin e projektit të paraqesë dëshmi të së drejtës për të shfrytëzuar pronën intelektuale në formën e një marrëveshje licencimi, marrëveshje kontributin jo-monetar ose lloj tjetër marrëveshjeje, i cili konfirmon se aplikuesi ka të drejtë të shfrytëzojë pronësinë intelektuale në të cilën bazohen rezultatet e projektit.

(6) Aplikuesi nuk duhet të cenojë me dashje ose me qëllim të drejtat e pronësisë intelektuale të ndonjë pale të tretë.

(7) Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe "know how" që do të krijohen gjatë zbatimit të projektit dhe/ose si rezultat i zbatimit të projektit i përkasin Shfrytëzuesit dhe nëse është e pranueshme, Shfrytëzuesi duhet të mbrojë të drejtat e pronësisë intelektuale.

(8) Si përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni, në rast të një propozim-projekti që përfshin një marrëveshje bashkëpunimi me një institucion të arsimit të lartë dhe/ose

kërkimit shkencor, të drejtat e pronësisë intelektuale në lidhje me projektin duhet të rregullohen qartë në marrëveshjen e bashkëpunimit.

(9) Fondi nuk do të jetë përgjegjës për mosmarrëveshjet mbi të drejtat e pronësisë intelektuale midis Aplikuesit/Shfrytëzuesit të mbështetjes financiare dhe palëve të treta.

(10) Çdo propozim-projekt i paraqitur në një konkurs publik për ndarjen e mjeteve në Fond duhet të jetë në përputhje me rregulloret në fuqi për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zvogëlimin e ndotjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(11) Fondi mbanë të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga Aplikuesi.

### **Aplikimi me procedurë të shkurtuar**

#### **Neni 16**

(1) Në një konkurs publik me procedurë të shkurtuar për marrjen e mjeteve financiare nga Fondi, kanë të drejtë të aplikojnë, propozim-projektet e të cilëve nuk janë miratuar nga Komiteti dhe kanë kaluar fazën e parapërzgjedhjes, në 12 muajt e mëparshëm nga momenti i shpalljes së konkursit.

(2) Aplikuesit e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, kur aplikojnë për marrjen e mjeteve financiare me procedurë të shkurtuar përmes këtij Instrumenti nga Fondi, duhet të dorëzojnë dokumentet vijuese:

- aplikimin e projektit;
- buxheti i projektit;
- CV-të (maksimumi deri në 5 (pesë) persona) për anëtarët e ekipit dhe
- deklaratë se nuk ka ndryshim në dokumentacionin e detyrueshëm, i cili ndikon në përshtatshmërinë e aplikuesit, e dorëzuar në thirrjen/konkursin e mëparshëm për të cilin ata aplikuan dhe që ata i përmbushin kushtet e përshtatshmërisë së konkursit që aplikojnë.

(3) Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesit në përputhje me këtë nen duhet gjithashtu të plotësojë kushtet e parashikuara në nenin 15, nga paragrafi (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij Rregulli.

(4) Propozim-projektet që aplikohen me procedurë të shkurtuar nuk do të kalojnë përsëri fazën e parapërzgjedhjes, por ato do të evoluohen dhe vlerësohen nga Komiteti në fazën e përzgjedhjes dhe do të rishikohen në fazën e rishikimit administrativ nga aspekti i përmbushjes së kushteve për përshtatshmëri.

(5) Gjatë paraqitjes së propozim-projekteve, Fondi do t'i paraqesë Komitetit aplikacionin e projektit, buxhetin e projektit dhe biografisë e shkurtra të anëtarëve të ekipit, historinë ose informacionin për aplikuesin ose shfrytëzuesin, si dhe dokumentacionin tjetër të ndikimit për të sjellë një vendim përfundimtar.

### **Dokumentacioni shtesë**

#### **Neni 17**

(1) Në rast se Aplikuesi zgjidhet për financim përmes këtij Instrumenti, para se të marrë një Vendim përfundimtar për financimi dhe/ose para nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve, Aplikuesi deri tek Fondi duhet të paraqesë dhe:

- marrëveshje me palët e treta me rëndësi për zbatimin e projektit (përfshirë kontratat e punonjësve);
- deklarata e ndihmës shtetërore të marrë më parë;
- njoftimi i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut nëse aplikuesi dhe themeluesi i tij/tyre janë themelues në persona të tjerë juridikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- të nënshkruar dhe të shtypur Plani i menaxhimit të mjedisit jetësor (nëse është i pranueshëm, respektivisht nëse propozim-projekti kategorizohet si rrezik mesatar nga eksperti i mjedisit jetësor);
- informacione mbi llogarinë e hapur të dedikuar për projektin;
- dokumentacion shtesë me të cilën vërtetohet plotësimi i kushteve për përshtatshmërinë e aplikuesit.

(2) Aplikuesi duhet të sigurojë dokumentet shtesë me afat deri në 5 ditë pune nga dita e marrjes së njoftimit nga Fondi.

(3) Fondi mbanë të drejtën nëse është e nevojshme të kërkohet edhe dokumentacion tjetër nga Aplikuesi i cili është i detyruar ta paraqesë atë sa më shpejt të jetë e mundur, ose nëse është e mundur Fondi mund të sigurojë vetë një dokumentacion të tillë, dhe në një rast të tillë, sipas dokumentacioneve shtesë, Fondi mund t'i kthejë të gjithë propozim-projektin Komitetit të rishikimit dhe vendimit.

### **III. PROCESI I VLERËSIMIT**

#### **Kriteret për vlerësimin e propozim-projekteve**

## Neni 18

(1) Kriteret bazë për vlerësimin e projekteve dhe ndarjen e mjeteve sipas këtij instrumenti janë:

- shkalla e inovacionit;
- cilësia e projektit;
- kapaciteti i ekipit të projektit;
- potenciali i tregut;
- ndikimi.

(2) Kriteret bazë dhe nën-kriteret për vlerësimin e projekteve jepen në formularin e Tabelës së Vlerësimit.

## Neni 19

(1) Të gjithë propozim-projektet që dorëzohen në kohë, Fondi ua dërgon ekspertëve në mënyrë që të zbatojnë fazën e parapërzgjedhjes.

(2) Me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, Fondi do të përcaktojë nëse deklaratat dhe pyetësi I mjedisit jetësor i referuar në nenin 15 dhe/ose nenin 16 të kësaj Rregullore janë nënshkruar dhe shtypur siç duhet dhe nëse jo, një njoftim i paraqitet aplikuesit për korrigjimin e tyre me afat prej 2 ditë pune nga njoftimi.

(3) Nëse deklaratat dhe pyetësi i mjedisit jetësor në paragrafin 2 të këtij neni të rregullores nuk janë korrigjuar siç duhet, gjegjësisht nuk plotësohen brenda afatit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, aplikimi/et nuk do të jetë/në shqyrtuar/ë nga ekspertët dhe/ose nga Komiteti. Në rast të arsyeve të justifikuara mirë, për shkak të të cilave aplikuesi nuk mund të bëjë korrigjimet e kërkuara ose të kompletojë deklaratat brenda afatit të caktuar, ai duhet të informojë menjëherë Fondin dhe ta justifikojë atë.

(4) Për të gjitha propozim-projektet, Fondi përgatit një tabelë, e cila ndër të tjera, përmban edhe të dhënat vijuese:

- emri i Aplikuesit;
- struktura e pronësisë së Aplikuesit; dhe
- personi i autorizuar (menaxher/drejtor) i Aplikuesit.

(5) Tabela e përmendur në paragrafin (4) të këtij neni u dorëzohet punonjësve të Fondit, Drejtorit të Fondit, anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit, Ekspertëve dhe anëtarëve të Komitetit të



miratimit të investimeve, me qëllim të përcaktohet konflikti i mundshëm i interesit në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

(6) Tabela e përmendur në paragrafin (4) të këtij neni u dërgohet personave të tjerë të përfshirë tërthorazi në proces, me qëllim që të përcaktohet konflikti i mundshëm i interesit në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

(7) Në rast se ndonjë nga Ekspertët identifikon një konflikt interesi, ai/ajo është i detyruar të informojë Fondin sa më shpejt të jetë e mundur. Fondi do ta përjashtojë një person të tillë nga procesi i vlerësimit (në fazën e parapërzgjedhjes) të atij propozim-projekti dhe do të emërojë një ekspert tjetër të përshtatshëm në vend të tij.

(8) Në rast se një nga anëtarët e Komitetit identifikon një konflikt interesi, ai/ajo është i detyruar të informojë Fondin sa më shpejt të jetë e mundur, pas së cilës ai/ajo do të përjashtohet nga procesi i vlerësimit (në fazën e përzgjedhjes) të atij propozim-projekti.

(9) Në rast se disa anëtarë të Komitetit identifikojnë konflikt interesi në lidhje me një propozim-projekt të caktuar dhe ai projekt nuk mund të vlerësohet nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Komitetit, projekti do të përjashtohet nga procedurat e mëtejshme dhe nuk do të vlerësohet.

## **Procesi i vlerësimit**

### **Neni 20**

(1) Vlerësimi i propozim-projekteve bëhet në dy faza: faza e parapërzgjedhjes dhe faza e përzgjedhjes.

(2) Faza e parapërzgjedhjes zbatohet nga Ekspertët. Çdo propozim-projekt do të vlerësohet në këtë fazë nga dy ekspertë të fushës që korrespondojnë me kriteret e vlerësimit, pra me mënyrat e Instrumentit dhe një person në fushën që korrespondon me propozim-projektin, përveç nëse bëhet fjalë për një propozim-projekt në përputhje me nenin 13 të këtij rregulli, një propozim-projekt i tillë nuk do të kalojë fazën e parapërzgjedhjes.

(3) Faza e përzgjedhjes zbatohet nga Komiteti i miratimit të investimeve, i cili merr vendimin përfundimtar për financimin përmes këtij Instrumenti.

(4) Të paktën tre nga anëtarët e Komitetit duhet të marrin pjesë në fazën e përzgjedhjes.

## **Faza e parapërzgjedhjes**

### **Neni 21**

(1) Në fazën e parapërzgjedhjes, Ekspertët, të emëruar nga Fondi, janë të detyruar të plotësojnë në mënyrë adekuate tabelën e vlerësimit për secilin nga propozim-projektet e ndara dhe të japin mendimin e ekspertit dhe vlerësimin e propozim-projekteve brenda 7 (shtatë) ditëve të punës nga dita e marrjes së propozim-projekteve.

(2) Në fazën e parapërzgjedhjes, Ekspertët kanë të drejtë të bëjnë pyetje shtesë për aplikuesit dhe propozim-projektet, të cilat do të kontrollohen nga punonjësit e Fondit. Drejtori i Fondit emëron persona që sigurojnë informacione të nevojshme shtesë përmes vizitave në terren tek Aplikuesi, komunikimi me njerëzit kryesorë mbi propozim-projektin dhe/ose verifikimin administrativ të informacioneve. Personat e emëruar janë të detyruar t'i sigurojnë informacionet e nevojshme brenda një afati të përcaktuar më parë nga Drejtori i Fondit.

(3) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për secilin propozim-projekt përcaktohet si një mesatare e notave të marra nga Ekspertët e emëruar për të vlerësuar atë propozim-projekt në fazën e parapërzgjedhjes.

(4) Çdo propozim-projekt që në fazën e parapërzgjedhjes ka marrë 51 (pesëdhjetë e një) pikë ose më shumë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) kalon në fazën tjetër të përzgjedhjes.

(5) Çdo propozim-projekt që në fazën e parapërzgjedhjes ka marrë më pak se 51 (pesëdhjetë e një) pikë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) refuzohet për financim sipas këtij Instrumenti për mbështetjen e Fondit.

(6) Çdo aplikues, propozim-projekti i të cilit nuk ka marrë të paktën 51 (pesëdhjetë e një) pikë, domethënë projekti i të cilit nuk e ka kaluar fazën e përzgjedhjes do të njoftohet menjëherë për rezultatet.

(7) Në rast të një aplikuesi, i cili i plotëson kriteret e përshtatshmërisë në përputhje me nenin 8 të këtij Rregulli dhe ka aplikuar për një konkurs publik me procedurë të shkurtuar, në përputhje me nenin 16 të këtij Rregulli, një propozim-projekt i tillë nuk do të kalojë faza e parapërzgjedhjes.

## **Faza e përzgjedhjes**

### **Neni 22**

(1) Në fazën e përzgjedhjes, secili anëtar i Komisionit kryen vlerësimin e propozim-projektit që kanë kaluar fazën e parapërzgjedhjes, pra propozim-projektet e paraqitura në konkursin publik me procedurë të shkurtuar dhe është i detyruar të plotësojë Tabelën e vlerësimit për secilin prej atyre propozim-projekteve dhe t'i vlerësojë ato brenda një afati të përcaktuar më parë nga Fondi.

(2) Anëtarët e Komitetit kanë të drejtë në fazën e përzgjedhjes të bëjnë pyetje shtesë për aplikuesit dhe propozim-projektet, të cilat do të kontrollohen nga Fondi. Drejtori emëron persona që sigurojnë informacione të nevojshme shtesë përmes vizitave në terren tek aplikuesi,

komunikimi me personat kryesorë të propozim-projektit dhe/ose verifikimin administrativ të informacioneve. Personat e emëruar janë të detyruar të sigurojnë informacione të nevojshme brenda një afati të përcaktuar më parë nga Fondi.

(3) Fondi mund të organizojë një prezantim të propozim-projekteve në fazën e përzgjedhjes. Në këtë prezantim, secili aplikues do të paraqesë shkurtimisht propozim-projektin e tij, dhe anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të bëjnë pyetje në mënyrë që të marrin informacione shtesë që do t'i ndihmojë ata në marrjen e vendimit.

(4) Nëse në fazën e përzgjedhjes Komiteti gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të propozim-projekteve ka nevojë për një mendim ekspertit në një fushë të caktuar, ai mund ta marrë atë nga ekspertët, në përputhje me një procedurë të përcaktuar me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punën e ekspertëve në punën e Fondit të inovacioneve dhe të zhvillimit teknologjik dhe dhënien e mendimit të ekspertëve ose nga ekspertët në fushën përkatëse dhe/ose nga institucionet relevante.

(5) Në fazën e përzgjedhjes, Fondi mund të angazhojë dhe persona të tjerë në cilësinë e vëzhguesve.

(6) Në fazën e përzgjedhjes, propozim-projektet e parapërzgjedhura rishikohen gjithashtu nga një ekspert për mjedisin jetësor. Eksperti për mjedisin jetësor është i detyruar të zbatojë të gjitha procedurat e nevojshme për vlerësimin e propozim-projekteve të parapërzgjedhura në përputhje me dokumentin Korniza për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Eksperti për mjedisin jetësor është i detyruar t'i paraqesë një raport Fondit për kategorizimin e propozim-projekteve të parapërzgjedhura. Sipas Kornizës së menaxhimit të mjedisit jetësor, Fondi nuk do të financojë projekte të kategorizuara nën "kategoria 3 - Rrezik i lartë".

(7) Vlerësimet dhe mendimet e ekspertëve të marra nga Ekspertët, historia e aplikuesve, gjegjësisht shfrytëzuesve dhe raportet për informacionet e siguruar shtesë nga Fondi, do t'u dorëzohen të gjithë anëtarëve të komitetit, të cilët janë të detyruar t'i marrin parasysh kur vlerësohen propozim-projektet.

(8) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për secilin propozim-projekt të përzgjedhur përcaktohet si një mesatare e notave nga Ekspertët të marra në fazën e parapërzgjedhjes dhe nga secili prej anëtarëve të Komitetit të marrë në fazën e përzgjedhjes.

(9) Në bazë të pikëve të fituara, përgatitet një listë indikative e renditjes së propozim-projekteve.

(10) Komiteti do të përpilojë një listë paraprake të propozim-projekteve që do t'i nënshtrohen rishikimit administrativ. Propozim-projektet për të cilat Komiteti i rishikimit administrativ do të përcaktojë se plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në rregullore dhe/ose që do të bëjnë korrigjimet e kërkuara në dokumentacionin dhe buxhetin e kërkuar, do t'i nënshtrohen vendimit përfundimtar nga Komiteti.

(11) Në rast se gjatë procedurës administrative është përcaktuar se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe/ose nuk kanë bërë korrigjimet e kërkuara në përputhje me nenin 23 paragrafi 7 të kësaj rregullore, Komiteti do të rishikojë në mënyrë të përshtatshme listën e propozim-projekteve që do të zgjidhen për financim.

### **Kontrolli administrativ**

#### **Neni 23**

(1) Me qëllim për të përcaktuar nëse aplikuesi i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në konkursin publik dhe në këtë rregullore, në bazë të dokumentacionit të përmendur në nenin 17 të këtij rregulli dhe rishikimit të buxheteve të paraqitura, krijohet komision (ose komisione) për procedurën administrative të propozim-projekteve të zgjedhura për financim. Komisioni (ose komisionet) shqyrton/jnë secilin aplikues dhe buxhet veç e veç.

(2) Komisioni për procedurën administrative formohet nga Drejtori i Fondit ose një person i autorizuar nga Drejtori i Fondit, dhe përbëhet nga të paktën tre punonjës/angazhues në Fond.

(3) Gjatë rishikimit të aplikuesve dhe buxheteve, Komisioni për procedurën administrative do të udhëhiqet sipas Dokumentit për procedurën administrative të propozim-projekteve.

(4) Nëse Komisionit për procedurën administrative gjatë rishikimit të propozim-projekteve i nevojitet një mendim ekspert nga një fushë e përshtatshme, një mendim i tillë ekspertësh do të sigurohet nga ekspertë të fushës përkatëse dhe/ose nga institucionet relevante.

(5) Pas përfundimit të procedurës administrative të propozim-projekteve, Komisioni për procedurën administrative përpilon procesverbal dhe i njëjti ia paraqet atë Komitetit.

(6) Nëse një aplikues nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar ose ka një buxhet të mbushur gabimisht të projektit, Komisioni për procedurën administrative e njofton Aplikuesin në mënyrë elektronike dhe i jep atij mundësinë brenda 5 (pesë) ditëve të punës t'i dorëzojë ato në mënyrë elektronike ose në arkivin e Fondit dokumentet që mungojnë dhe/ose të dorëzojë një buxhet të korrigjuar të projektit dhe/ose dokumentacion tjetër shtesë. Në rast të dorëzimit shtesë të dokumenteve, ndryshimet në aplikimin e projektit ose në buxhetin e projektit që nuk kërkohen nga Fondi nuk lejohen.

(7) Nëse Aplikuesi nuk i dorëzon dokumentet që mungojnë brenda 5 (pesë) ditëve shtesë të punës, nuk korrigjon buxhetin ose Aplikuesi nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në këtë Rregullore, Komisioni për procedurën administrative do të shënojë në procesverbal që për atë Aplikues, pra propozim-projekti nuk i plotëson kushtet për një vendim përfundimtar për financim.

(8) Procesverbali i referuar në paragrafin (5) të këtij neni, së bashku me dokumentet e kompletuara për procedurën administrative të propozim-projekteve, përgatiten nga Komisioni për procedurën administrative.

## **Vendimi për financim**

### **Neni 24**

(1) Vendimi përfundimtar për financimin e propozim-projekteve me këtë Instrument do të merret nga Komiteti në një mbledhje të mbajtur brenda një maksimum prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga paraqitja e propozim-projektit në Komitet.

(2) Vendimi përfundimtar për financimin do të merret nga Komiteti gjatë mbledhjes me votim publik "PËR" ose "KUNDËR" ndarjen e mjeteve për një propozim-projekt të caktuar. Mjetet për një propozim-projekt të caktuar në fazën e përzgjedhjes mund të ndahen vetëm nëse të paktën tre anëtarë të Komitetit votuan "PËR" ndarjen e mjeteve për atë propozim-projekt.

(3) Gjatë marrjes së vendimit për financim, buxheti në dispozicion për financim në secilin konkurs publik ka ndikim. Komiteti mund të sjellë vendim për financimin e propozim-projekteve brenda buxhetit të përcaktuar fillimisht për konkursin publik, ose nëse ai buxhet rritet më vonë për konkursin konkret.

(4) Nëse Komiteti miraton një vendim që është në kundërshtim me vlerësimin dhe mendimin e ekspertit të përgatitur nga Ekspertët, ai duhet të përmbajë një shpjegim të hollësishëm të arsyeve për sjelljen e një vendimi të tillë.

(5) Nëse nuk ka mjaft propozim-projekte të miratuara për financim të paraqitura në konkursin publik për këtë Instrument, mjetet e pashfrytëzuara nga buxheti në konkursin publik mund të ridedikohen në një konkurs publik tjetër për këtë Instrument ose mjete në vlerë prej 30% nga buxheti i thirrjes publike mund të rishpërndahet nga një konkurs publik në tjetrin për një instrument tjetër të Fondit nëse ka disa propozim-projektesh të përshtatshme për financim për atë instrument.

(6) Unifikimi i komenteve mbi propozim-projektet që janë refuzuar për financim në fazën e përzgjedhjes do të bëhet nga një anëtar i Komitetit, i emëruar nga Fondi, i cili ka vlerësuar propozim-projektet.

(7) Kur merr një vendim përfundimtar për financim, Komiteti do të marrë parasysh Procesverbalin e komisionit (komisioneve) për procedurën administrative.

(8) Çdo aplikues, propozim-projekt i të cilit ka kaluar fazën e përzgjedhjes dhe procedurën administrative, do të njoftohet për rezultatet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e vendimit përfundimtar për financimin nga Komiteti.

(9) Në rast se në të njëjtin konkurs publik paraqiten propozim-projektet e njëjta ose të ngjashme, Komiteti do të rishqyrtojë propozim-projektet e tilla dhe do të marrë një vendim të përshtatshëm.

(10) Aplikuesit, propozim-projektet e të cilëve nuk do të miratohen për financim, mund përsëri të aplikojnë për marrjen e mjeteve nga Fondi deri në tre herë me të njëjtin propozim-projekt.

## **IV NDARJA E MJETEVE**

### **Lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve**

#### **Neni 25**

(1) Aplikuesit për të cilët është marrë një vendim për financim nënshkruajnë një Kontratë për ndarjen e mjeteve.

(2) Para nënshkrimit të një Kontrate për ndajren e mjeteve përmes këtij Instrumenti, Shfrytëzuesi duhet të ketë një llogari bankare të hapur ose me synim të veçantë për qëllimet e projektit.

(3) Fondi dhe Aplikuesi për të cilët është marrë një vendim financimi do të lidhin një Kontratë për ndarjen e mjeteve në një formë dhe përmbajtje të përcaktuar në thelb nga Fondi.

(4) Në rast se aplikuesit për të cilët është marrë një vendim financimi nuk qasen me nënshkrimin e Kontratës për ndarjen e mjeteve brenda një afati të arsyeshëm, Komiteti mund t'u kërkojë atyre të nënshkruajnë Kontratën brenda një afati të caktuar.

(5) Nëse aplikuesit nuk e nënshkruajnë Kontratën e financimit brenda afatit të përcaktuar nga Komiteti, Komiteti do të rishqyrtojë dhe/ose ndryshojë vendimin.

### **Pagesa e mjeteve**

#### **Neni 26**

(1) Të gjitha pagesat nga Fondi dhe pagesat për bashkëfinancimin e Shfrytëzuesit do të realizohen në llogarinë bankare me synim të veçantë.

(2) Fondi do të paguajë mjetet e ndara me këtë Instrument paraprakisht, në baza tremujore në përputhje me buxhetin e projektit, Kontratën për ndarjen e mjeteve dhe dispozitat e përcaktuara në këtë Rregullore.

(3) Shfrytëzuesi do të paguajë mjetet nga bashkëfinancimi i tij, në përputhje me Buxhetin e Projektit, Kontratën për ndarjen e mjeteve dhe dispozitat e përcaktuara në këtë Rregullore.

(4) Fondi do të paguajë mjetet e ndara me këtë Instrument për tremujorin e parë pas nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve, pasi Shfrytëzuesi t'i paraqesë Fondit dëshmi të pagesës së kryer të bashkëfinancimit të tij për tremujorin e parë në formën e një lloj certifikate bankare nga llogaria bankare me synim të veçantë.

(5) Pas nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve, Shfrytëzuesi brenda 45 ditëve duhet të bëjë pagesën e bashkëfinancimit të tij për tremujorin e parë, përndryshe Fondi ka të drejtë të përfundojë kontratën.

(6) Fondi do të paguajë mjetet e ndara me këtë Instrument për çdo tremujor të ardhshëm pasi të plotësohen kushtet vijuese:

- raporti i miratuar tremujor i progresit për tremujorin e mëparshëm (pjesa përshkruese dhe financiare);
- shpenzime të caktuara të paktën 70% (shtatëdhjetë përqind) të mjeteve të buxhetuara më parë;
- paraqitja e dëshmis për pagesën e bashkëfinancimit të tij për tremujorin e ardhshëm në llojin e një certifikatës bankare nga llogaria e veçantë.

(7) Nga pagesa e fundit për Shfrytëzuesin përmes këtij Instrumenti, Fondi mbanë 5% (pesë përqind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

(8) Procedura për pagesën e mjeteve të mbajtura të referuara në paragrafin (7) të këtij neni fillon brenda 14 ditëve të punës nga dita e miratimit të raportit Përfundimtar për projektin (pjesa përshkruese dhe financiare).

(9) Në rast të mjeteve të pashpenzuara dhe/ose në rast keqpërdorimi, një shumë e përshtatshme e mjeteve të mbajtura nuk do t'i paguhet Shfrytëzuesit.

## **V. ZBATIMI DHE MBIKËQYRJA E PROJEKTIT**

### **Rregulla të përgjithshme për zbatimin e projektit**

#### **Neni 27**

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar të zbatojë projektin në përputhje me kushtet e përshkruara në këtë Rregullore dhe në Kontratën për ndarjen e mjeteve, si dhe në përputhje me teknikën e mirë, standardet dhe praktikat ekonomike, financiare, menaxheriale, ekologjike dhe sociale dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Shfrytëzuesi ka një detyrim për të zbatuar projektin në mënyrë efektive dhe efikase, në përputhje me aplikimin e Projektit dhe Buxhetin e projektit.

(3) Shfrytëzuesi është i detyruar të mbajë evidencë financiare-kontabiliste, në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe në mënyrën më të përshtatshme për aktivitetet e projektit, burimet dhe shpenzimet në dispozicion në lidhje me projektin dhe do të përgatisë raporte financiare në Fond në përputhje me kontabilitetin e parasë në dorë, duke paraqitur qartë dokumentet për shpenzimin e bërë dhe pagesat për tremujorin në të cilin ato referohen, në një mënyrë që do të korrespondojë me aktivitetet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin.

(4) Shfrytëzuesi, si dhe furnizuesit, konsulentët dhe pjesëmarrësit e zgjedhur në projekt kërkohet t'i përmbahen Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, në mënyrë që të parandalojnë korrupsionin dhe fenomenet e lidhura me të gjatë zbatimit të kontratës.

## **Neni 28**

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar të shlyejë rregullisht detyrimet e tij ndaj Fondit në bazë të pagesës së honorareve.

(2) Në rast të ndërprerjes ose zgjidhjes së kontratës për ndarjen e mjeteve, Fondi mbanë të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi që të kthejë një pjesë ose të gjitha mjetet e marra, në përputhje me kushtet në kontratë.

(3) Pagesat e Shfrytëzuesit në Fond duhet të bëhen në denarë.

(4) Fondi mban evidencë për shërbimin e obligimeve që kanë shfrytëzuesit e mjeteve ndaj Fondit.

(5) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për shlyerjen e detyrimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi i dërgon një paralajmërim të parë me shkrim shfrytëzuesit për vonesën.

(6) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, Fondi i dërgon një paralajmërim të dytë me shkrim shfrytëzuesit për vonesën.

(7) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, Fondi mbanë të drejtën të përfundojë në mënyrë të njëanshme kontratën për ndarjen e mjeteve dhe të aktivizojë instrumentet e mbrojtjes nëse e njëjta parashikohet.

(8) Për çdo vonesë në pagesën e detyrimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi mbanë të drejtën për të llogaritur dhe mbledhur kamatën ligjore të ndëshkimit në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



## **Furnizimi i mallrave, shërbimeve dhe punëve**

### **Neni 29**

(1) Çdo furnizim i mallrave dhe shërbimeve do të kryhet nga Shfrytëzuesi në përputhje me praktikatat e deklaruara komercialisht të pranueshme, dhe atë:

- kur zbatojnë furnizimet e parashikuara në projekt, shfrytëzuesit duhet të marrin parasysh marrin parasysh nevojën ekonomike, efikasitetin, transparencën dhe kohëzgjatjen e procedurës së furnizimit, si dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të furnizuara.
- për furnizimet që tejkalojnë 615,000.00 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë) denarë, shfrytëzuesi duhet të kryejë një procedurë duke mbledhur së paku tre oferta. Shfrytëzuesi duhet të paraqesë dokumentacionin për miratim deri tek Fondi.
- në raste të justifikuara mirë, furnizimet nga nënparagrafi 2 i këtij paragrafi mund të kryhen pa procedurën e deklaruar pas miratimit paraprak nga Fondi.

(2) Aty ku është e zbatueshme, kontratat midis shfrytëzuesit dhe palëve të treta duhet të përfshijnë dispozita në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, parandalimin e konfliktit të interesit, revizionin dhe ndikimin në mjedisin jetësor.

## **Transparenca dhe komunikimi me publikun**

### **Neni 30**

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar të ndjekë udhëzimet e Fondit dhe Komitetit në lidhje me transparencën dhe komunikimin e projektit me publikun në përputhje me Udhëzimet për transparencën dhe komunikimin e projekteve të Fondit.

(2) Gjatë kohës së zbatimit të projektit, Shfrytëzuesi është i detyruar të shënojë të gjithë materialet promovuese për projektin me logon dhe titullin e Fondit dhe të deklarojë qartë se projekti është zbatuar me mbështetje financiare nga Fondi.

(3) Pajisjet e furnizuara përmes projektit të financuar nga Fondi duhet të shënohen qartë me logon e Fondit, si dhe me një shënim: "*Mbështetur nga Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut*".

(4) Nëse Shfrytëzuesi zotëron një faqe-interneti, ai/ajo është i detyruar të publikojë informacion të shkurtër për mbështetjen financiare të siguar nga Fondi.

(5) Nëse Shfrytëzuesi publikon ose jep një deklaratë për mediat në lidhje me projektin, ai/ajo është i detyruar të përmendë mbështetjen e siguar nga Fondi.

## **Ndryshimi i projektit dhe rishpërndarja e mjeteve nga Buxheti për projektin**

### **Neni 31**

(1) Çdo ndryshim i projektit duhet të justifikohet në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritshme të projektit.

(2) Shfrytëzuesi është i detyruar të realizojë shpenzimet në mënyrë dinamike dhe brenda shumave të treguara në buxhetin e projektit.

(3) Shfrytëzuesi ka të drejtë të rishpërndajë mjetet midis zërave të buxhetit në shumën e përgjithshme prej 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit në mënyrë që të arrijë rezultatet e pritshme të projektit. Shfrytëzuesi informon Fondin për rishpërndarjen brenda raporteve tremujore dhe raportin përfundimtar për projektin. Nëse brenda një zëri të buxhetit brenda zbatimit të projektit ndodhin ndryshime në lidhje me shpenzimet e parashikuara fillimisht, diferenca midis shumës së parashikuar dhe shumës së paguar nuk do të konsiderohet si rishpërndarje nëse e njëjta mbulohet nga disa kursime të shpenzimit brenda një zëri tjetër të buxhetit.

(4) Çdo ndryshim në aplikimin e projektit dhe buxhetin e projektit (ndryshimet në planin e aktiviteteve, personat kryesorë në projekt, rishpërndarja e mjeteve në një shumë më të madhe se 15% (pesëmbëdhjetë përqind) midis zërave të buxhetit nga buxheti i përgjithshëm i projektit, etj) duhet të miratohet më parë nga Komiteti në bazë të një kërkesë të paraqitur nga Shfrytëzuesi me një buxhet të rishikuar të projektit të bashkangjitur.

(5) Në rast të rishpërndarjes së mjeteve të miratuara nga Fondi, Shfrytëzuesi është i detyruar të realizojë shpenzimet në përputhje me buxhetin e projektit të rishikuar.

## **Ruajtja e dokumentacionit**

### **Neni 32**

(1) Shfrytëzuesi duhet të mbajë të gjithë dokumentacionin e projektit që nga fillimi i zbatimit të projektit.

(2) Dokumentacioni i detyrueshëm i projektit duhet të përmbajë:

- dokumentacionin e projektit dhe dokumentacionin në lidhje me Shfrytëzuesin;
- të gjitha dokumentet zyrtare të komunikimit midis Shfrytëzuesit dhe Fondit gjatë periudhës së aplikimit;

- njoftim për ndarjen e mjeteve;
- kontratë për ndarjen e mjeteve;
- të gjitha dokumentet zyrtare gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe gjatë kohës së detyrimit të njoftimit;
- kopjet origjinale të të gjitha raporteve të paraqitura në Fond;
- njoftimet për miratimin e raporteve të paraqitura në Fond;
- kopjet origjinale të të gjitha faturave dhe
- gjitha dokumenteve të tjera, përfshirë edhe kontratat me palët e treta dhe dëshmi të tjera të pagesës në lidhje me projektin.

(3) Shfrytëzuesi është i detyruar të ruajë dokumentacionin e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni për të paktën 10 vjet pas përfundimit të projektit.

(4) Të gjitha informacionet në lidhje me kontratat dhe furnizimet në lidhje me projektin duhet të jenë të disponueshme për rishikim nga punonjësit e Fondit dhe/ose personat e autorizuar nga Fondi.

## **VI. VËZHGIMI DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTEVE**

### **Qëllimi dhe metodat e vëzhgimit dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve**

#### **Neni 33**

(1) Qëllimi i vëzhgimit dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve është vëzhgimi i përparimit të projektit dhe zbatimi i aktiviteteve të planifikuara, të vërtetohet se shpenzimet e realizuara janë në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit për periudhën e caktuar dhe në përputhje me procedurat e Fondit, si dhe për të vlerësuar rezultatet e arritura pas përfundimit të projektit.

(2) Metodat e vëzhgimit dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve përfshijnë:

- rishikimin dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga shfrytëzuesi;
- vizita në terren të shfrytëzuesve;
- vlerësimi i rezultateve të arritura nga projekti dhe analiza e thelluar biznesore dhe financiare.

(3) Vëzhgimi dhe vlerësimi i rezultateve të projekteve do të kryhet nga ekipet vëzhguese të krijuara nga Fondi dhe/ose ekspertët e revizimit të emëruar nga Fondi dhe/ose revizorët e

jashtëm nga shoqëritë e autorizuar të revizorit të zgjedhur me vendim të Fondit në një procedurë të përshtatshme.

## **Raportet**

### **Neni 34**

(1) Shfrytëzuesi duhet deri tek Fondi të paraqet raporte, dhe atë:

- raportet tremujore të përparimit (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare) të cilat Shfrytëzuesi do t'i paraqesë për kohëzgjatjen e projektit dhe atë brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve pas skadimit të ditës së fundit kalendarike të tremujorit.
- raporti përfundimtar (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare) të cilën Shfrytëzuesi e paraqet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas përfundimit të ditës së fundit kalendarike të projektit, dhe brenda së cilës periudhë Shfrytëzuesi gjithashtu duhet t'i kryejë pagesat për të gjitha aktivitetet e projektit të zbatuara deri në skadimin e ditës së fundit të Kontratës për ndarjen e mjeteve dhe
- në 5 (pesë) vitet e ardhshme pas përfundimit të projektit, më së voni deri më 31 mars të këtij viti të paraqesin një raport vjetor mbi vëzhgimin e aktiviteteve pas përfundimit të projektit.

(2) Raportet tremujore, raporti përfundimtar dhe raporti vjetor për vëzhgimin e aktiviteteve pas përfundimit të projektit, plotësohen në formularët e përgatitur nga Fondi.

(3) Raportet do të rishikohen nga ekipet vëzhguese dhe/ose ekspertët e revizorit të emëruar nga Drejtori i Fondit. Në rast të parregullsive të identifikuara në njoftim që mund të korrigjohen nga Shfrytëzuesi, Fondi njofton Shfrytëzuesin për parregullsitë e identifikuara me një kërkesë për të eliminuar parregullsitë dhe për të paraqitur një raport të rishikuar.

(4) Në rast se raporti është plotësuar dhe dorëzuar siç duhet, Fondi do të miratojë raportin dhe do t'ia dorëzojë miratimin Shfrytëzuesit.

(5) Ekipi i vëzhgimit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente shtesë në lidhje me raportet nga Shfrytëzuesi, si dhe të bëjë një vizitë të njoftuar në terren tek Shfrytëzuesi në mënyrë që të kontrollojë informacionet e paraqitura në raporte.

## **Vizitat në terren**

### **Neni 35**

(1) Fondi mbikëqyr zbatimin e projektit dhe përmes vizitave në terren tek shfrytëzuesit, të cilat do të kryhen nga ekipet vëzhguese, ekspertët e revizorit të emëruar nga Fondi dhe/ose anëtarët e Komitetit.

(2) Është e detyrueshme të kryhet të paktën një vizitë në terren për projekt. Fondi ka të drejtë të kryejë më shumë vizita në terren nëse është e nevojshme.

(3) Vizitat në terren përfshijnë një vizitë në hapësirat e biznesit të Shfrytëzuesit dhe një takim me njerëzit kryesorë të projektit në mënyrë që të mbikëqyrin zbatimin e projektit (p.sh. pajtueshmërinë e procedurave, arritja e rezultateve të pritura, pajtueshmërinë e kornizës kohore , pajtueshmërinë me dispozitat e Kontratës për ndarjen e mjeteve, etj.).

(4) Vizita në terren do të shpallet. Fondi i dërgon Shfrytëzuesit një njoftim paraprak për kryerjen e një vizite në terren e cila përmban detaje rreth vendndodhjes, kohës së vizitës, personave që duhet të jenë të pranishëm, dokumentacionit dhe pajisjeve të furnizuara që duhet të jenë në dispozicion për rishikim. Njoftimi për kryerjen e një vizite në terren dorëzohet të paktën 3 (tre) ditë para zbatimit të vizitës.

(5) Nëse Fondi vlerëson nevojën, mund të kryejë një vizitë të paparalajmëruar në terren.

(6) Për vizitën e kryer në terren, përpilohet një raport nga vizita e kryer në terren, në të cilën futen të dhënat për vizitën, personat që kanë ndjekur vizitën në terren, dokumentacioni i kontrolluar, vërejtjet e konstatuara nga vizita në terren, parregullsitë e identifikuar, udhëzimet dhe afatet për heqjen e parregullsive të mundshme dhe të tjerë.

(7) Shfrytëzuesit i dorëzohet një raport nga vizita e kryer në terren. Në rast të parregullsive të konstatuara, Shfrytëzuesi është i detyruar të marrë masa në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara në njoftim. Fondi nuk do të bëjë pagesa për mjetet e ndara sipas këtij Instrumenti për tremujorin e ardhshëm derisa Shfrytëzuesi të heqë çdo parregullsi të identifikuar eventualisht në raport.

### **Duke vepruar në rast të parregullsive të identifikuar**

#### **Neni 36**

(1) Gjatë zbatimit të projekteve, ekipet vëzhguese, nëse gjejnë parregullsi që mund të tejkalojnë autorizimet e tyre, mund t'i paraqesin një propozim drejtorit të Fondit për të thirrur një takim të Komitetit për vendimmarrje të parregullsive të identifikuar.

(2) Gjatë zbatimit të projekteve, në vëzhgim mund të përfshihen edhe ekspertët e revizionit në përputhje me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së ekspertëve të revizionit në punën e Fondit të inovacioneve dhe të zhvillimit teknologjik dhe dhënien e mendimit të ekspertëve.

(3) Pas përfundimit të projektit, për vlerësimin e rezultateve dhe/ose analizën e thelluar biznesor dhe financave të projekteve të financuara, ekspertët e revizionit mund të angazhohen në përputhje me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së ekspertëve të revizionit në punën e Fondit të inovacioneve dhe të zhvillimit teknologjik dhe dhënien e mendimit të ekspertëve.

(4) Eksperti i revizionit i referuar në paragrafët (2) dhe paragrafin (3) të këtij neni është i detyruar të rishikojë dokumentacionin e projektit, të bëjë një vizitë në terren te Shfrytëzuesi (nëse është e nevojshme) dhe të paraqesë një raport dhe mendim eksperti tek Fondi brenda 14 ditëve të punës nga dita e marrjes së dokumentacionit.

### **Bashkëpunimi i Shfrytëzuesit me Fondin**

#### **Neni 37**

(1) Shfrytëzuesi është i detyruar t'i përmbahet procedurave dhe t'i mundësojë Fondit të vëzhgojë dhe vlerësojë me lehtësi zbatimin e projektit.

(2) Shfrytëzuesi i mundëson Fondit ose personave të autorizuar nga Fondi në çdo kohë të kryejnë një analizë të thelluar të zbatimit të projektit, aktiviteteve të tij dhe rezultateve të arritura, si dhe të kryejnë revizion projektin dhe dokumentacionin financiar në lidhje me projektin. Shfrytëzuesi duhet të përgatisë dhe dorëzojë të gjitha dokumentet përkatëse në lidhje me projektin në Fond me kërkesën e tij.

### **Të drejtat dhe detyrimet me rezultatet e projektit**

#### **Neni 38**

(1) Shfrytëzuesi do të zotërojë rezultatet e projektit që ai do të krijojë.

(2) Shfrytëzuesi do të marrë masa për të siguruar eksploatimin komercial të rezultateve të projektit, drejtpërdrejt ose tërthorazi në atë mënyrë që: të shfrytëzojë ato në kërkime të tjera që nuk mbulohen nga projekti, duke zhvilluar, krijuar ose vendosur në treg një produkt ose proces, do të krijojë ose sigurojë një shërbim, ose do t'i shfrytëzojnë ato për qëllime standardizimi dhe do t'i marrë ato masa për kohëzgjatjen e projektit deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(3) Shfrytëzuesi mund të transferojë pronësinë e rezultateve të projektit tek një palë tjetër, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

(4) Shfrytëzuesi që synon të transferojë pronësinë mbi rezultatet e projektit ose të japë një licencë ekskluzive për shfrytëzimin e rezultateve të projektit tek një palë tjetër, duhet të informojë Fondin paraprakisht në formë shkrimi para transferimit ose dhënies në fjalë të licencës

së përmendur dhe të kërkojë pëlqimin e Fondit në mënyrë që të mund të zbatohet e njëjta. Në një njoftim të tillë me shkrim, shfrytëzuesi do të deklarojë saktësisht se cilat rezultate të projektit ka ndërmend të përcjellë, domethënë të japë dhe do të japë të dhëna të detajuara në lidhje me pronarin e ri, pra shfrytëzuesin e licencës, si dhe për planifikimin ose eksploatimin komercial potencial të rezultateve të projektit, dhe do të paraqesë një analizë të arsyetuar të ndikimit të mundshëm të transferimit ose licencimit në konkurrencën e tregut dhe pajtueshmërinë e tij me rregullat e mira etike dhe interesat e sigurisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Fondi mund të kërkojë informacione shtesë.

(5) Fondi mund të refuzojë dhënien e pëlqimit për transferimin e planifikuar të pronësisë mbi rezultatet e projektit, domethënë dhënien e planifikuar të një licence ekskluzive për shfrytëzimin e rezultateve të projektit, veçanërisht:

a) nëse pronari i ri, pra shfrytëzuesi ekskluziv i licencës është shtetas i huaj ose person juridik i themeluar jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut;

b) nëse Fondi konstaton se transferimi i planifikuar, domethënë licencimi nuk është në përputhje me parimet e konkurrencës, parimet e mira etike, apo interesat e sigurisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Fondi do të njoftojë shfrytëzuesin në formë shkrimi për vendimin e tij në lidhje me kërkesën e përmendur në paragrafin (4) të këtij neni brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit, pra nga dita e marrjes së çdo informacioni shtesë që Fondi mund të kërkojë. Fondi në vendimin e tij mund të vendosë kushte shtesë sipas të cilave transferimi i planifikuar i pronësisë, domethënë dhënia e planifikuar e një licence ekskluzive mund të kryhet.

(6) Shfrytëzuesi nuk duhet të transferojë pronësinë mbi rezultatet e projektit ose të japë një licence ekskluzive për të shfrytëzuar rezultatet e projektit tek një palë tjetër derisa nuk merrë pëlqimin e Fondit, domethënë derisa të plotësojë kushtet shtesë që Fondi mund t'i imponojë ato për të kryer transferimin e planifikuar të pronësisë, domethënë mund të realizohet dhënia e planifikuar të një licence ekskluzive.

(7) Shfrytëzuesi duhet të sigurohet që pronari i ri i rezultateve të projektit do të jetë i detyruar të respektojë dispozitat e mësipërme të këtij neni dhe se ai do të jetë i detyruar të sigurojë që çdo pronar i mëvonshëm i rezultateve të projektit është i detyruar të respektojë dispozitat e këtij rregulli.

(8) Detyrimet e shfrytëzuesit nga ky nen janë të vlefshme për kohëzgjatjen e projektit si dhe deri në përmbylljen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit në përputhje me kontratën për ndarjen e mjeteve.

(9) Nëse shfrytëzuesi ka vepruar në një mënyrë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, Fondi mbanë të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi që të kthejë të gjithë shumën ose një pjesë të shumës së mjeteve të ndara. Për këto detyrime Fondi mbanë të drejtën nga dita e arritjes deri në ditën e

arkëtimit për të llogaritur dhe mbledhur kamatën e ndëshkimit ligjor në përputhje me Ligjin e Marrënieve të Detyrimeve.

### **Detyrimi për të paguar honoraret**

#### **Neni 39**

(1) Në rast të mjeteve të ndara në formën e një granti të bashkëfinancuar, pas komercializimit të suksesshëm, të ardhurat e arritura si rezultat i projektit të marrë nga shitja e produktit/shërbimit ose ndonjë tjetër pasuese produkt/shërbim i bazuar në teknologjinë / procesi i zhvilluar brenda projektit të financuar nga Fondi bëhet baza për pagesën e honorareve për Fondin.

(2) Çdo pagesë e honorareve bëhet me një normë prej 5% të të ardhurave vjetore të shfrytëzuesit të arritur duke shitur produktin / shërbimin që rezulton nga projekti, deri në një kthim prej 100% (njëqind për qind) të shumës së paguar nga Fondi, ose për një periudhë pesëvjeçare pas përfundimit të projektit, varësisht se cili kusht është përmbushur për herë të parë.

(3) Shuma e honorareve llogaritet çdo vit në vitin aktual për vitin e kaluar, dhe duhet t'i paguhet Shfrytëzuesit të Fondi më së voni deri më 31 mars të vitit aktual për vitin e kaluar.

(4) Në rast se për kohëzgjatjen e projektit, deri në miratimin e raportit Përfundimtar nga Fondi, shfrytëzuesi paraqet dëshmi të investitorit tërheqës i cili ka investuar një shumë që arrinë të paktën 50% të shumës së mbështetjes financiare të ndarë nga Fondi për shfrytëzuesin, shfrytëzuesi do të lirohet nga detyrimi për të paguar honoraret. Dëshmi e investimit do të konsiderohet kontrata, situata aktuale dhe dëshmia bërjes së pagesës së investimit.

### **Detyrimet në rast të përfundimit të Shfrytëzuesit**

#### **Neni 40**

(1) Në rast të përfundimit (likuidimit) të planifikuar të Shfrytëzuesit, Shfrytëzuesi i paraqet një kërkesë Fondit dhe pas marrjes së miratimit paraprak nga Fondi mund të fillojë një procedurë për përfundimin (likuidimin). Pas kësaj kërkesë, Fondi merr një vendim sa më shpejt të jetë e mundur. Një procedurë e tillë përfundimi (likuidimi) nuk duhet të fillojë pa një vendim me të cilin Fondi jep miratimin paraprak për të.

(2) Në rast se paraqitet një propozim për fillimin e një procedure falimentimi kundër Shfrytëzuesit, Shfrytëzuesi do ta njoftojë Fondin me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga gjetja e një propozimi të tillë.



(3) Detyrimet e Shfrytëzuesit të përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni do të zgjasin në periudhën nga lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve midis Fondit dhe Shfrytëzuesit deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(4) Nëse në periudhën e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, Shfrytëzuesi fillon një procedurë për përfundimin (likuidimin) pa miratimin paraprak të Fondit ose nuk e njofton Fondin brenda afatit të përmendur në paragrafin (2) të këtij neni për një propozim të paraqitur për fillimin e procedurave të falimentimit kundër tij, Fondi mund të kërkojë nga Shfrytëzuesi që të kthejë shumën e plotë ose një pjesë të shumës së mjeteve të ndara. Për këto detyrime, Fondi mund nga dita e arritjes deri në ditën e arkëtimit të llogarisë dhe të arkëtojë interesin ligjor me vonesë në përputhje me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimit.

## **Ndryshimet në pronësinë e kapitalit dhe ndryshimet e statusit**

### **Neni 41**

(1) Nëse në periudhën nga lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve midis Fondit dhe Shfrytëzuesit deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit sipas kontratës për ndarjen e mjeteve, zbatohet ndryshimi i pronësisë së kapitalit, Shfrytëzuesi është i detyruar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e regjistrimit të ndryshimit të tillë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut të informojë Fondin për ndryshimet e mbetura.

### **Neni 42**

(1) Në rast të ndryshimit të planifikuar të statusit të Shfrytëzuesit, Shfrytëzuesi është i detyruar të paraqesë një kërkesë në Fond dhe të marrë miratimin paraprak nga Fondi në mënyrë që të mund të zbatojë një ndryshim të tillë të planifikuar. Me këtë kërkesë, Fondi është i detyruar të marrë një vendim sa më shpejt të jetë e mundur. Një ndryshim i tillë i planifikuar nuk duhet të zbatohet pa një vendim me të cilin Fondi jep miratimin e tij paraprak.

(2) Nëse Fondi miraton ndryshimin e planifikuar të statusit të Shfrytëzuesit, pronari i ri i shfrytëzuesit, pra pasardhësi ligjor i Shfrytëzuesit është i detyruar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas përshkrimit të ndryshimit të statusit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut të lidhë një aneks me Fondin e kontratës për ndarjen e mjeteve me të cilat merr të drejtat dhe detyrimet prej saj.

(3) Detyrimi i Shfrytëzuesit të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni do të zgjasë në periudhën nga përfundimi i kontratës për ndarjen e mjeteve midis Fondit dhe shfrytëzuesit deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Fondit në përputhje me kontratën për ndarjen e mjeteve.

(4) Nëse në periudhën e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, një ndryshim i statusit zbatohet me Shfrytëzuesin pa miratimin paraprak të Fondit, Fondi mbanë të drejtën të kërkojë nga Shfrytëzuesi që të kthejë të gjithë shumën ose një pjesë të shumës së mjeteve të ndara. Për këto detyrime, Fondi mbanë të drejtën që nga dita e arritjes deri në ditën e arkëtimit për të llogaritur dhe arkëtuar interesin ligjor me vonesë në përputhje me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

## **VII. NDËRPRERJA E FINANCIMIT**

### **Neni 43**

Fondi mbanë të drejtën të pezullojë përkohësisht financimin sipas një kontrate të lidhur për ndarjen e mjeteve, tërësisht ose pjesërisht, veçanërisht në rastet vijuese:

- nëse kërkesa për pagesë nga Shfrytëzuesi nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore dhe/ose nga kontrata për ndarjen e mjeteve;
- asnjë raport nuk është dorëzuar që Shfrytëzuesi duhet të paraqesë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore, ose raporti i tillë është i paplotë ose nevojiten informacione shtesë;
- ekzistojnë dyshime në Fond me përshtatshmërinë për të financuar shpenzimet e paraqitura në raporte dhe nevojiten kontrole shtesë;
- Shfrytëzuesi ka kryer ose ekziston dyshimi nga Fondi se Shfrytëzuesi ka kryer shkelje serioze të detyrimeve sipas kontratës për ndarjen e mjeteve, dhe/ose dispozitave nga kjo Rregullore;
- Shfrytëzuesi ka kryer ose ekziston dyshimi nga Fondi se Shfrytëzuesi ka kryer mashtrim ose përvetësim, përfshirë edhe në procedurën e ndarjes së mjeteve;
- në rast se është paraqitur një propozim për fillimin e një procedure falimentimi kundër shfrytëzuesit.

### **Neni 44**

(1) Në rast të shfaqjes së ndonjë prej rrethanave nga neni 43 i këtij Rregulli, Fondi mbanë të drejtën të marrë një vendim për ndërprerjen e përkohshme të financimit dhe/ose të kërkojë

kthimin e një pjese ose të të gjitha mjeteve financiare të paguara nga Shfrytëzuesi deri në atë moment.

(2) Njëkohësisht me vendimin për ndërprerjen e përkohshme të financimit, Fondi i dërgon një njoftim me shkrim Shfrytëzuesit që e informon atë për shkeljet e kontratës për ndarjen e mjeteve me një kërkesë që Shfrytëzuesi të eliminojë shkeljet brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditë nga dita e marrjes së njoftimit.

(3) Me kërkesë të Shfrytëzuesit, Fondi mund t'i miratojë Shfrytëzuesit një shtesë prej 30 (tridhjetë) ditësh për eliminimin e shkeljeve. Në raste të caktuara për të cilat pritet një vendim nga një organ i përshtatshëm në lidhje me funksionimin e Shfrytëzuesit, i cili ka ndikim në pezullimin e përkohshëm të financimit, afati për eliminimin e këtyre shkeljeve mund të vazhdohet deri në përfundimin e zgjidhjes të atij organi.

(4) Në rast se Shfrytëzuesi tejkalon shkeljet e identifikuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin (2) dhe paragrafin (3) të këtij neni, Fondi do të marrë vendim për tërheqjen e ndërprerjes së përkohshme të financimit.

(5) Në rast se Shfrytëzuesi nuk i eliminon shkeljet e identifikuar brenda afateve nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni, Drejtori i Fondit do të informojë Komitetin, i cili do të vendosë nëse kontrata do të përfundojë. Në çdo rast, Komiteti, kur vendos të përfundojë Kontratën, mund të marrë parasysh shkallën e shfrytëzimit të projektit (përparimin e projektit dhe realizimin e tij).

## **VIII. ZGJIDHJA E KONTRATËS PËR NDARJEN E MJETEVE**

### **Neni 45**

Fondi mbanë të drejtën të zgjidh kontratën për ndarjen e mjeteve plotësisht ose pjesërisht, në rast të përvetësimit dhe shkeljes së detyrimeve sipas kontratës për ndarjen e mjeteve, dhe/ose dispozitave të kësaj Rregullore, në veçanti në rastet vijuese:

1. Nëse Shfrytëzuesi nuk përdor me qëllim mjetet financiare të miratuara, duke përfshirë rishpërndarjen e mjeteve në një përqindje më të lartë se përqindja e përcaktuar e mjeteve nga buxheti i përgjithshëm i projektit në përputhje me nenin 31;
2. Nëse Shfrytëzuesi me qëllim të mashtrimit jep të dhëna të pasakta gjatë procedurës për ndarjen e mjeteve dhe për kohëzgjatjen e kontratës për ndarjen e mjeteve që kanë ndikim material në projekt;

3. Nëse Shfrytëzuesi nuk prezanton politikat dhe procedurat e duhura që do t'i mundësojnë Fondit të kryejë mbikëqyrje dhe të vlerësojë përparimin e projektit;
4. Nëse Shfrytëzuesi nuk prezanton dhe mban një sistem të menaxhimit financiar dhe nuk I përgatit raportet financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit në një mënyrë që do të pasqyrojë në mënyrë adekuate aktivitetet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin;
5. Nëse Shfrytëzuesi me kërkesë të Fondit nuk lejon një revizion nga një revizor i pavarur dhe/ose një ekspert revizion i emëruar nga Fondi;
6. Nëse Shfrytëzuesi nuk siguron Fondin dhe/ose personat e emëruar nga Fondi, për të inspektuar zbatimin e projektit, aktivitetet e tij, rezultatet e arritura dhe të gjitha dokumentet relevante për projektin, ose për të paraqitur llogaritë dhe/ose të njëjtat tek Fondi i kërkesës së tij;
7. Nëse Shfrytëzuesi nuk njofton Fondin për ndonjë ndryshim të rëndësishëm me ndikim material rreth projektit;
8. Nëse Shfrytëzuesi vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 paragrafi 4 të këtij Rregulli që i referohen mashtrimit dhe korrupsionit;
9. Nëse Shfrytëzuesi vepron me rezultatet e projektit në një mënyrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 38 të këtij Rregulli.
10. Nëse shfrytëzuesi nuk respekton dispozitat e nenit 40, 41 dhe/ose 42 të këtij Rregulli në rast të ndryshimeve në pronësinë e kapitalit, domethënë strukturës së pronësisë, ndryshimeve të statusit dhe përfundimit;
11. Në rast se është paraqitur një propozim për fillimin e një procedure falimentimi kundër shfrytëzuesit.

#### **Neni 46**

- (1) Në rast të shfaqjes së ndonjëres prej rrethanave të përmendura në nenin 45 të këtij Rregulli, Fondi mbanë të drejtën të marrë një vendim për zgjidhjen e kontratës dhe/ose të kërkojë kthimin e një pjese ose të të gjithë mjeteve financiare që i është paguar Shfrytëzuesit deri në atë moment.
- (2) Vendimin për zgjidhjen e kontratës për ndarjen e mjeteve dhe financimin e merr Komiteti.
- (3) Në rast të zgjidhjes së kontratës, Fondi mbanë të drejtën të kërkojë një rimbursim të të gjithë ose një pjese të shumës së paguar nga Fondi për Shfrytëzuesin, dhe veçanërisht në rastet që

lidhen me kushtet e përmendura në nenin 45 paragrafi 1 nënparagrafi 2 , 5, 6 dhe 8 të këtij Rregulli, Fondi mbanë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

(4) Nëse kontrata për ndarjen e mjeteve është zgjidhur për çfarëdo arsye të mbuluar nga neni 44 i këtij Rregulli dhe mjetet financiare të ndara nuk shpenzohen, shfrytëzuesi është i detyruar t'i kthejë Fondit të gjithë shumën e pashpenzuar të mjeteve brenda një periudhe të përcaktuar nga Fondi, por jo më pak se 8 (tetë) ditë, përndryshe ai bie në vonesë dhe në të njëjtën shumë mund të detyrohet të paguajë kamatë ligjore të ndëshkimit në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve e llogaritur nga dita e vonesës, deri në pagesën përfundimtare.

(5) Në rast se ndodhin kushtet e përmendura në nenin 45, paragrafi 1 nënparagrafi 9 dhe/ose 10 të këtij Rregulli, Fondi mbanë të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi të kthejë një shumë të plotë ose një pjesë të mjeteve të paguara nga Fondi për Shfrytëzuesin. Nga data e caktuar deri në ditën e pagesës, Fondi mbanë të drejtën për të llogaritur dhe mbledhur kamatën e ndëshkimit ligjor në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve.

(6) Fondi ka të drejtë të kërkojë interes gjorbë, kompensim dhe të fillojë një procedurë të përshtatshme për sigurimin e kërkesave nga shfrytëzuesi në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratë dhe në këtë Rregullore, sa më shpejt të jetë e mundur, nëse Shfrytëzuesi nuk i përmbushë kushtet e caktuara në paragrafin 3, 4 dhe 5 të këtij neni në mënyrë që të bëjë një kthim të plotë të mjeteve të paguara tashmë tek shfrytëzuesi.

(7) Të gjitha pagesat duhet t'i paguhen Fondit në denarë.

(8) Në çdo rast, kur vendos të ndërpresë kontratën, Fondi mund të marrë parasysh shkallën e shfrytëzimit të projektit (përparimin e projektit dhe realizimin e tij).

#### **Neni 47**

(1) Fondi mund të përfundojë kontratën për ndarjen e mjeteve në bazë të një kërkesë të Shfrytëzuesit ose ekipit të vëzhgimit, nëse për shkak të një pengese të pashmangshme nga aspekti teknik ose i tregut, rezultatet e ardhshme të projektit vihen në pikëpyetje.

(2) Në rastin e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, Fondi do t'i kërkojë shfrytëzuesit të dorëzojë dokumentacionin në Fond dhe të kërkojë përfundimin e projektit dhe financimin. Më pas, Komiteti do të përcaktojë nëse ka justifikim për dëshminë e një pengese të pashmangshme që vë në pikëpyetje rezultatet e ardhshme të projektit dhe do të marrë një vendim të përshtatshëm. Nëse Komiteti vendos se kushtet e përmbushura në paragrafin (1) të këtij neni janë përmbushur, Shfrytëzuesi nuk do të jetë i detyruar t'i kthejë mjetet e ndara.

#### **IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 48**

Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e rregulloreve ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 49**

Në kontratën për ndarjen e mjeteve të lidhura me Fondin deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore do të zbatohen akte të përshtatshme të Fondit në përputhje me të njejtat që janë të lidhura.

### **Neni 50**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Rregulli, Rregullorja për instrumentin për grante të bashkë-financuara nga mbështetja për komercializimin e inovacioneve nr.01-528/5 deri më 11.02.2019 dhe 01-1425/12 deri më 04.07.2019

### **Neni 51**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e publikimit të tij në tabelën e Shpalljes të Fondit, dhe pëlqimi i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të publikohet.

Nr. \_\_\_\_\_ **Kryetare e Bordit Drejtues**

**Shkup,** \_\_\_\_\_ **vjet Monika Jovanova**